

ESI Newsletter 4/2022  
16 maj 2022

## Përsëri 47? Rusia del jashtë, Kosova hyn brenda



*Ai u dëbua. Ajo dëshiron të hyjë. Presidentët e Rusisë dhe Kosovës.*

Të dashur miq,

Është e habitshme se sa ndryshe janë trajtuar Rusia dhe Kosova nga qeveritë e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës në vitet e fundit.

Rusia, një superfuqi bërthamore me një popullsi prej 146 milionë banorësh dhe një masë tokësore që shtrihet përtej nëntë zona kohore, iu bashkua Këshillit të Evropës në 1996. Si anëtare e Këshillit të Evropës, Rusia bëri luftëra në Çeçeni (1999-2000), pushtoi Gjeorgjinë (2008), aneksoi Krimenë (2014), shkaktoi luftë në Ukrainën Lindore (nga 2014), bombardoi civilët në Siri (nga 2015) dhe më pas filloi një sulm kundër Ukrainës në shkurt 2022.

Kosova, një nga demokracitë më të vogla të Evropës me një popullsi prej më pak se 2 milionë banorë, me një territor që është 0.05 përqind ai i Rusisë, shpalli pavarësinë e saj në shkurt 2008. Kjo u njoh nga një shumicë e madhe e anëtarëve të Këshillit të Evropës (34 nga 46).



*Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë*

Në tetor 2008, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara iu drejtua Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë (GJND) në Hagë me një pyetje të thjeshtë: “A është deklarata e njëanshme e pavarësisë nga Institucionet e Përkohshme të Vetëqeverisjes së Kosovës në përputhje me ligjin ndërkombëtar?” [Në korrik 2010, GJND-ja arriti në përfundimin](#) se “shpallja e pavarësisë së Kosova e miratuar më 17 shkurt 2008 nuk ka shkelur të drejtën ndërkombëtare”.

Ndryshe nga Rusia, Kosova ka parë tranzicione paqësore të pushtetit politik duke ndjekur rrugën e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Ndryshe nga Rusia, Kosova e pavarur nuk ka pasur kurrë të burgosur politik. Ndryshe nga Rusia, ajo nuk ka bërë asnjë luftë.

E megjithatë, për shumë vite, qeveritë e Kosovës janë dekurajuar në mënyrë aktive nga aplikimi për anëtarësimin në Këshillin e Evropës nga anëtarët e tjerë. Rezultati: Kosova mbetet jashtë. Ajo është sot e vetmja demokraci evropiane që nuk është ende anëtare e Këshillit të Evropës.



*Pushtimi i Rosisë në Ukrainë*

Pushtimi i fundit i Rosisë në Ukrainë, i kombinuar me kërcënimet e liderëve të saj kundër vendeve anëtare të Këshillit të Evropës, ishte i tepërt.

Më 15 mars të këtij viti, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës miratoi një [mendim](#). Ajo konsideroi se Federata Ruse nuk mund të jetë më një shtet anëtar i Organizatës. Vendimi ishte unanim. Po atë ditë, [qeveria ruse njoftoi tërheqjen e saj](#).

Pas më shumë se një çerek shekulli që ishte anëtare, Rusia ishte jashtë. Menjëherë pas kësaj, Qeveria e Kosovës njoftoi synimin e saj për të aplikuar për të zënë vendin e Rosisë si anëtar i 47-të. Më 12 maj, javën e kaluar, ministrja e jashtme e Kosovës dorëzoi aplikacionin e Kosovës në Strasburg.

### **Çfarë duhet të ndodhë më pas**

Çfarë ndodh më pas?

*Nëse Kosova trajtohet si vendet e tjera në të kaluarën, do të ndodhë si më poshtë.*

Aplikimi i Kosovës tashmë është në Komitetin e Ministrave, ku përfaqësuesit e 46 shteteve anëtare takohen rregullisht. Ajo duhet të shkojë pranë Asamblesë Parlamentare të Këshilli i Evropës (PACE).

Aty do shkruhen raporte të thelluara, për të vlerësuar nëse Kosova i përmbush kriteret. Bazuar në këto raporte, fillimisht PACE dhe më pas Komiteti i Ministrave duhet të votojnë aplikacionin.

Hapi tjetër është i qartë. Një votim në Komitetin e Ministrave është i nevojshëm në mbledhjen e tij të ardhshme për të dërguar aplikacionin në PACE, ku fillon puna e vërtetë.

Më 4 maj 1992, pas përmbysjes së diktaturës komuniste në Tiranë, Shqipëria aplikoi për t'u anëtarësuar në Këshillin e Evropës. Më 21 maj 1992, menjëherë pas kësaj, Komiteti i Ministrave i kërkoi Asamblesë Parlamentare të jepte një mendim.

Më 9 nëntor 2000, pasi Slllobodan Millosheviq u rrëzua në Beograd, Republika Federale e Jugosllavisë aplikoi për anëtarësim në Këshillin e Evropës. Më 22 nëntor 2000, Komisioni i Ministrave i kërkoi Asamblesë Parlamentare të jepte një opinion.

Zhvendosja e aplikacionit të Kosovës nga Komiteti i Ministrave – 46 qeveritë – në PACE – anëtarët e parlamentit – nuk duhet të zgjasë shumë. Ajo duhet të ndodhë më 20 maj në takimim e radhës të ministrave të jashtëm të Komitetit të Ministrave në Torino.



*Torino*

Italia aktualisht kryeson Komitetin e Ministrave. Luigi di Maio, ministri i Jashtëm italian, shpesh është shprehur në favor të integritetit të Kosovës në institucionet evropiane.

Në një vizitë në Kosovë në qershor 2021, [Luigi Di Maio deklaroi](#): “Italia është e bindur plotësisht se e ardhmja e Kosovës qëndron në Evropë dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë zërin tonë të dëgjohet në Bruksel mbi çështje të ndryshme të agjendës (evropiane)”.



Shumë qeveri të tjera kanë folur në këtë mënyrë.

Në një vizitë të kryeministrit të Kosovës në Paris në qershor 2021, presidenti francez [Emmanuel Macron deklaroi](#): “Kosova, si të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, ka vokacionin, kur vjen koha dhe kur kushtet të plotësohen plotësisht, për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian”.

Anëtarësimi në Këshillin e Evropës – dhe në këtë mënyrë pranimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut – janë kërkuar gjithmonë përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Franca tani duhet të mbështesë PACE në vlerësimin nëse kushtet për të janë përmbushur.

Gjatë një vizite në Kosovë në mars 2022, ministrja e Jashtme gjermane Annalena Baerbock, [vlerësoi](#) “orientimin e fuqishëm reformues” të qeverisë së re të Kosovës: “Kosova ka bërë pjesën e saj, tani të njëjtën duhet ta bëjë dhe Bashkimi Evropian”.



*Olaf Scholz dhe Albin Kurti në Berlin*

Në një vizitë në Berlin nga kryeministri i Kosovës në maj 2022, kancelari gjerman [Olaf Scholz](#) [lavdëroi Kosovën dhe premtoi mbështetjen e Gjermanisë](#):

“Kosova shumë herët ka marrë qëndrim të qartë për të gjitha çështjet ndërkombëtare, në koordinim me BE, dhe po mbështet sanksionet kundër Rusisë. Kjo meriton një njohje të madhe ...

Ballkani Perëndimor i përket Evropës. Në të ardhmen të gjitha vendet e saj duhet t'i përkasin gjithashtu Bashkimi Evropian. Këtu përfshihet sigurisht edhe Kosova, njohja ndërkombëtare e së cilës është mbështetur gjithmonë nga Gjermania me të gjitha mundësitë e saj dhe vazhdon të mbështesë.”

Kështu, si Italia dhe Franca, edhe Gjermania duhet të mbështesë që PACE të vlerësojë nëse janë përmbushur kushtet që Kosova t'i bashkohet organizatës më të vjetër të të drejtave të njeriut në Evropë.

### **Standarde të dyfishta në Strasburg**

Megjithatë, është thelbësore që hapi tjetër të merret në Torino këtë muaj në [seancën ministrore të 20 majit](#).

Ministrat takohen vetëm një herë në vit. Por, zëvendësministrat – ambasadorët në Strasburg – mund të marrin vendime për të gjitha çështjet në mbledhjet e tyre të rregullta javore.

Por në këto takime çdo vend mund të këmbëngulë që një artikull duhet “për shkak të rëndësisë së tij politike do të trajtohet nga takimi i Komitetit të Ministrave në nivel ministror” (neni 2, [Rregullorja e Punës për mbledhjet e Zëvendës Ministrave](#)).

Kjo do të thotë: nëse nuk merret vendim në mbledhjen e 20 majit të këtij viti, aplikimi mund të ngrihet lehtësisht nga një shtet i vetëm anëtar për një vit të tërë.

Në takimin ministror në Torino, megjithatë, kalimi I aplikimit të Kosovës në PACE merr "një shumicë prej dy të tretave të të gjithë përfaqësuesve që kanë të drejtë të marrin pjesë në Komision" ([neni 20 të statutit](#)).

34 nga 46 shtetet anëtare të Këshillit të Evropës e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Të tjerët, si Greqia, e kanë mbështetur Kosovën që t'i bashkohet institucioneve ndërkombëtare edhe pa këtë.

Në Komitetin e Ministrave në Torino nevojiten 31 vota për dërgimin e aplikimit në PACE.

Votat janë. Precedentët janë. Premtimet janë. Por a do të ndodhë?

A e kishin seriozisht vendet si Gjermania dhe Franca atë që u thanë liderëve të Kosovës muajve të fundit?

Ose standardi i dyfishtë, i cili lejoi Rusinë të ishte anëtare, pavarësisht nga shkeljet masive të të drejtave të njeriut, por që e bllokuan Kosovën të aplikojë, do të vazhdojë?

Në tetor 2018, ministria e jashtme gjermane u dërgoi një notë të brendshme diplomatëve të saj duke argumentuar se ambasadat gjermane duhet t'i shtyjnë vendet e tjera të bëjnë lëshime që Rusia e Putinit kishte kërkuar, në këmbim të paguante edhe një herë kontributet e detyrueshme

në Këshillin e Evropës. Rreziku që Rusia të largohet ndonjëherë nga Këshilli i Evropës, kështu ishte qëndrimi i Ministrisë së Punëve të Jashtme gjermane në atë kohë, ishte "një krizë ekzistenciale":

#### Russia's role in the Council of Europe

- The Council of Europe is headed for an existential crisis. There is a risk of Russia's entire rights being suspended in mid-2019 if it does not start paying its contributions to the Council again. The termination of its membership could then no longer be ruled out. The most important political forces in all Member States should be aware of this and do what they can to avert this scenario, as the German Government is doing.
- Why are we doing this? Without Russia and its approximately 144 million inhabitants, the benefits of the Council of Europe, as the oldest pan-European organisation, over other actors such as the EU would be doubtful. Other countries such as Turkey and Azerbaijan could feel tempted to follow Russia's example.

Memorandumi theksoi se sa e rëndësishme ishte që qytetarët rusë të ruanin aksesin në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

- Above all, however, the Council of Europe and its institutions play a major role in fostering human rights, the rule of law and democracy in all of its Member States, including Russia. Most importantly, people in Russia would not have access to the European Court of Human Rights if the country were no longer involved in the Council of Europe.

Në rastin e aplikimit të fundit të Kosovës, megjithatë, një memo e brendshme e fundit gjermane i është dërguar anëtarëve të PACE në prill 2022 ku sugjerohet që Kosova as formalisht *nuk mund të aplikonte* për anëtarësim; që do të duhej të ishte ftuar në *bazë të konsensusit* të të gjithë anëtarëve; se një konsensus i tillë ishte i *paimagjinueshëm* për shkak të kundërshtimit serb; dhe se Kosovës duhet t'i ofrohet më mirë – në konsultim (“*Abstimmung*”) me Serbinë – *alternativa* ndaj anëtarësimit.

Një alternativë, e paraqitur në memon e prillit, është që Kosova të pranohet si anëtarë bashkëpunuese "si Saar".

Ky është një krahasim i jashtëzakonshëm.

Midis 1950 dhe 1957, “Saar” ishte një protektorat francez. Partive pro-gjermane (si CDU) iu ndalua kandidimi në zgjedhje. Nuk ka qenë kurrë një shtet sovran. Në vitin 1957, Saar ishte pjesë integruese e Republikës Federale të Gjermanisë si “Saarland”. Si mund të jetë “Saar” një model për një shtet sovran?

Paradoksi është se ndërsa disa diplomatë gjermanë në Strasburg kanë argumentuar në takimet me diplomatë të tjerë *kundër* trajtimit të aplikimit të Kosovës si ai i Shqipërisë në 1992 dhe të Serbia në vitin 2010, në javët e fundit, qëndrimi zyrtar i Gjermanisë është se e *mbështet* plotësisht Kosovën. Kjo ngre pyetjen: kush e bën politikën e jashtme gjermane?

Më 4 maj, qeveria gjermane iu përgjigj një pyetjeje lidhur me këtë nga një anëtar gjerman i PACE: [Andreas Michaelis](#), sekretar i shtetit në Ministrinë e Jashtme, e bëri të qartë se “Qeveria mbështet anëtarësimin e Republikës së Kosovës në Këshillin e Evropës.”



An das  
Mitglied des Deutschen Bundestages  
Herrn Knut Abraham  
Platz der Republik 1  
11011 Berlin

Andreas Michaelis  
Staatssekretär

Berlin, den 4. Mai 2022

Schriftliche Fragen für den Monat April 2022  
Frage Nr. 4-280

Sehr geehrter Herr Abgeordneter,

Ihre Frage:

*Wenn die Republik Kosovo in naher Zukunft eine Mitgliedschaft im Europarat anstrebt (laut FAZ Artikel am 23.04 ist eine Bewerbung wahrscheinlich), was nach Ansicht des Fragestellers Menschenrechte und Minderheitenrechte im Kosovo nach durch den Zugang zum EGRM stärken würde, würde die Bundesregierung dies begrüßen und diese Bewerbung dann auch unterstützen?*

beantworte ich wie folgt:

Die Bundesregierung unterstützt die Mitgliedschaft der Republik Kosovo im Europarat. Wichtig ist es, dafür in enger Abstimmung mit unseren Partnern in EU und Europarat zu bleiben.

Mit freundlichen Grüßen

Po të njëjtin qëndrim kanë edhe shumica e anëtarëve të parlamentit gjerman në PACE. Ka mbështetje të fuqishme dypartiake në mbështetje të aplikimit të Kosovës nga anëtarët e partive qeverisëse dhe nga partitë kryesore opozitare në Bundestag.

Frank Schwabe i SPD, i cili drejton grupin e socialistëve, demokratëve dhe të gjelbërve të PACE, postoi në Twitter:

“Ne duhet ta afrojmë Kosovën me Evropën. Një mundësi e mirë do të ishte anëtarësimi në Këshillin e Evropës. Në këtë mënyrë humbasim një anëtar, Rusinë. Kosova do të bashkohej. Dhe ne mbetemi në 47.”



Frank Schwabe #FreeAlexanderKabanov  
@FrankSchwabe

Replying to @AuswaertigesAmt @ABAerbock and @albinkurti

Wir sollten das Kosovo näher an Europa führen. Eine gute Möglichkeit dazu wäre die Mitgliedschaft im Europarat. So verlieren wir ein Land, Russland. Das #Kosovo käme neu dazu. Einfach zu merken. Bleibt bei 47. @rumeliobserver @vjlashala @MiRo\_SPD

Translate Tweet

21:29 · 10.03.22 from Geneva, Switzerland · Twitter for iPad

Knut Abraham i CDU-së, anëtar i komiteteve të punëve të jashtme dhe të të drejtave të njeriut në Bundestag kërkoi në një [deklaratë për shtyp](#) që “qeveria të mbështesë anëtarësimin e Kosovës në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës”. Konstantin Kuhle i liberalëve FDP gjithashtu [miratoi anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës](#) si “një kontribut të rëndësishëm për stabilitetin në Ballkanin Perëndimor.”

Pas aplikimit të Kosovës, ambasadori i Gjermanisë në Kosovë ka shkruar në Twitter se “Mezi pres ta shoh Kosovën si pjesë e familjes @coe së Këshillit të Evropës” dhe uroi “Gjithë të mirat për aplikimin e anëtarësimit!” Manuel Sarrazin, i dërguari special i qeverisë gjermane për vendet e Ballkanit Perëndimor, vizitoi ministren e Jashtme të Kosovës në Prishtinë dhe e siguroi atë për “mbështetjen e Gjermanisë për aplikimin për anëtarësim!”.



Ambassador Jörn Rohde  
@GermanAmbKOS

Looking forward to seeing Kosovo as part of the Council of Europe @coe family who work together to promote human rights, democracy and the rule of law.

Kosovo belongs in the Council of Europe.

All the best for the membership bid!



Albin Kurti @albinkurti · 1d

Today, our MFA @gervallaschwarz handed over Kosovo's application to @coe. Our full membership would not only be a strong signal to all democratic forces in the region but also a major step for Europe as a whole, with whom we share our commitment to the protection of human rights.

12:31 · 13.05.22 · Twitter for iPhone

Ka pasur shumë argumente të çuditshme nga diplomatë gjermanë dhe të tjerë në Strasburg javët e fundit në takimet me kolegët e tyre nga shtetet e tjera anëtare:

- Aplikimi i Kosovës vjen “shumë herët” – kjo pas disa muajsh që po diskutohej nga anëtarët gjermanë të PACE.
- Aplikimi i Kosovës është shumë përçarës për Këshillin e Evropës – kjo kur anëtarë të Këshillit të Evropës kanë qenë në luftë me njëri-tjetrin vitet e fundit (Rusia sulmon Gjeorgjinë dhe Ukrainën, Armenia dhe Azerbajxhani duke luftuar në 2021).
- Kosova duhet të përqendrohet fillimisht në çështje të tjera në diskutimet e saj me Serbinë – kjo kur Serbia është anëtare e Këshillit të Evropës për më shumë se dy dekada tashmë.

Ajo që nevojitet në Torino është përcjellja e aplikimit në PACE, qëllimi i të cilit është të ofrojë mbrojtjen e të drejtave humane të gjithë qytetarëve të Kosovës, duke përfshirë edhe pakicat.

Kjo është e gjitha. Mirëpo, nëse edhe kjo nuk bëhet, çfarë kuptimi ka të përsëritet se Kosova ka një thirrje evropiane?

Ky është, në fakt, momenti i së vërtetës për shumë vende evropiane që kanë pretenduar prej kohësh se mbështesin aspiratat evropiane të Kosovës. Është gjithashtu momenti i së vërtetës për Komitetin e Ministrave.

Demokracitë evropiane, të dërgojnë në Torino një sinjal të fortë se Këshilli i Evropës është vendi ku përkasin demokracitë evropiane. Nuk do të ketë kurrë një kohë më të mirë se tani për ta bërë këtë.

Miqësisht,

Gerald Knaus

[@rumeliobserver](https://twitter.com/rumeliobserver)

Kristof Bender

[@kristofbender](https://twitter.com/kristofbender)



EUROPARAT

## Russland raus, Kosovo rein?

Nach Russlands Ausschluss aus dem Europarat steigen die Chancen zur Aufnahme eines anderen Bewerbers. Wird das Kosovo bald Mitglied?

Von Michael Martens



Nicht mehr dabei: Der Europarat ohne Russland Bild: dpa

*“[Russia out, Kosovo in?](#)”, Frankfurter Allgemeine Zeitung, 23 prill 2022*

*The European Stability Initiative is being supported by Stiftung Mercator*

STIFTUNG  
**MERCATOR**  
FOUNDATION